

Urdhëresa mbi Udhëtimet Hyrëse në Lidhje me Koronavirusin—e vlefshme si fillim që nga 15 Shtatori

Për cilët individë vlen detyrimi për të qëndruar në karantinë në shtëpi, kur hyjnë në vend?

Qeveria federale dhe Landet kanë rënë dakord që njerëzit të cilët hyjnë në vend nga zonat me rrezik duhet të qëndrojnë kryesisht 14 ditë në karantinë në shtëpi.

Cilat shtete konsiderohen si zona me rrezik?

Zonat me rrezik caktohen nga qeveria federale dhe publikohen nga Instituti Robert Koch (RKI). Këtu përfshihen edhe numri i rasteve edhe një vlerësim i shkallës së testimit dhe të infektimit. Ju mund ta gjeni një pasqyrë të zonave aktuale me rrezik [këtu](#).

Cilat janë përjashtimet nga rregulli i karantinës që vlejné duke filluar nga 15 Korrik 2020?

Detyrimi i karantinës për udhëtarët e kthyer nga zonat me rrezik nuk vlen nëse paraqitet një test negativ koronavirusi i cili është kryer më pak se 48 orë para hyrjes. Koha kur është përcaktuar rezultati i testimit është vendimtare për afatin e fundit. Testi mund të përsëritet gjithashtu në Gjermani; gjithsesi, rregullat e karantinës duhet të zbatohen si fillim derisa të merret rezultati negativ. Për më tepër, ekzistojnë përjashtime, p.sh për individët të cilët për arsye profesionale transportojnë përmes kufinjve individë, mallra ose produkte nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, detar ose ajror si dhe për individë të cilët hyjnë në Gjermani për më pak se 72 orë për arsye specifike (vizitë nga familjarë, kujdestari, vizitë nga partnerët e jetës, etj.). Përveç kësaj, nuk vlen më detyrimi për karantinë për personat të cilët ndodhen në tranzit përmes Nordrhein-Westfalen (pa qëndruar tërë natën).

A mund të testohen për koronavirusin në aeroportet e Nordrhein-Westfalen udhëtarët e kthyer nga zonat me rrezik?

Po. Udhëtarët e kthyer nga zonat me rrezik mund të testohen falas për koronavirusin në 4 aeroporte në Nordrhein-Westfalen . Qendrat e testimit në aeroportet e Köln/Bonn, Düsseldorf dhe Dortmund e nisnin punën në 25 korrik, qendra e testimit në aeroportin e Münster/Osnabrück e nis punën në 28 Korrik.

Cilët individë mund të testohen falas në qendrat e testimit të aeroporteve?

Mund të testohen aty të gjithë të kthyerit nga zonat me rrezik (këtu vlejné [Informacione për identifikimin e zonave ndërkombëtare me rrezik sipas RKI](#)).

Si funksionon testimi në qendrat e testimit në aeroporte?

Procedurat në qendrat e testimit në aeroporte si Düsseldorf, Dortmund dhe Münster/Osnabrück janë të organizuara nga Shoqatat e Mjekëve të Sigurimit Ligjor të Shëndetit Publik. Testimet zhvillohen nga mjekët dhe mjeket të cilët punojnë me honorare si dhe stafi mjekësor teknik. Tek aeroporti i Köln/Bonn testimet do të zhvillohen nga Johanniter Unfallhilfe.

Kur do të jenë të gatshme rezultatet e testimit?

Udhëtarët mund ta kontrollojnë zakonisht brenda 3 ditëve online rezultatin e testimit. Deri sa të jetë prezent një rezultat negativ i testimit, ata janë të detyruar të qëndrojnë në karantinë në shtëpi sipas Urdhëresës për Udhëtimet Hyrëse në Lidhje me Koronavirusin.

A duhet të testohen në aeroporte udhëtarët e kthyer nga zonat me rrezik?

Si rregull, udhëtarët të cilët hyjnë në vend nga zonat me rrezik duhet të qëndrojnë 14 ditë në karantinë në shtëpi. Detyrimi i karantinës për individët e kthyer nga zonat me rrezik nuk vlen nëse ka një rezultat negativ testimi për koronavirusin, i cili është zhvilluar jo më shumë se 48 orë para hyrjes. Koha kur është përcaktuar rezultati i testimit është vendimtare për afatin e fundit. Testimi mund të përsëritet gjithashtu në Gjermani, për shembull në qendrat e testimit në aeroporte. Rregullat juridike të Urdhëresës për Udhëtimet Hyrëse në Lidhje me Koronavirusin vazhdojnë të vlejnjë për udhëtarët e kthyer nga zonat me rrezik.